



UDHËZUES

**PËR REALIZIMIN E TË DREJTAVE TË PERSONAVE ME AFTËSI TË
KUFIZUARA**

BAZUAR NË KORNIZEN LIGJORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PRISHTINË, Dhjetor 2017

Përmbajtja

Parathënie	3
Ligji për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë.....	4
Ligji për personat e verbër.....	6
Ligji për shëndetin mendor.....	7
Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti.....	9
Ligji për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme.....	11
Subvencionet e Komunave për personat me aftësi të kufizuara të përhershme.....	12
Ligji për aftësimin , riaftësimin profesional dhe punësimi i personave me aftësi të kufizuara..	13
Transporti shkollor për fëmijët me aftësi të kufizuara.....	14
Lehtësirat doganore për persona me aftësi të kufizuara.....	15
Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi.....	18

PARATHËNIE

Të nderuar lexues,

Duke ju dëshiruar lexim të dobishëm, ju informojmë se ky udhëzues është hartuar nga HANDIKOS, për të shpjeguar ligjet aktuale që rregullojnë fushën e aftësisë së kufizuar në Republikën e Kosovës.

HANDIKOS (Shoqata e paraplegjikëve dhe e paralizës së fëmijëve të Kosovës), shoqatë e personave me aftësi të kufizuara në vazhden e punës së saj në përparimin e të drejtave dhe pozitës së personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës, efektivishtë punon në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, duke marrë pjesë aktive në proceset e hartimit dhe konsultimeve publike të politikave dhe legjislacionit për personat me aftësi të kufizuara.

HANDIKOS vazhdon të jetë qendër gjithëpërfshirëse e informimit mbi aftësinë e kufizuar në Kosovë, duke publikuar një mori të raporteve, broshurave, informatorëve dhe udhëzuesëve për personat me aftësi të kufizuara, të drejtat e tyre, përfitimet, jetën e pavarur, kujdesin personal etj.

Me këtë udhëzues synojmë të rrisim nivelin e njohurive për të drejtat dhe ligjet në fuqi që kanë të bëjnë me të drejtat dhe përfitimet e personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, i cili përveç se do t'i informojë së pari vetë personat me aftësi të kufizuara, do të jetë një burim i rëndësishëm informimi për autoritet publike zbatuese të ligjeve.

Udhëzuesi përmban informatat kryesore nga ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, të cilat drejtpërdrejtë apo indirekt rregullojnë mbrojtjen, të drejtat dhe përfitimet e personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës

LIGJI PËR STATUSIN DHE TË DREJTAT E PERSONAVE PARAPLEGJIKË DHE TETRAPLEGJIKË

Ligji për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë është miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës më 25 maj 2016, ndërsa ka hyrë në fuqi më 1 korrik po të atij viti, me përjashtim të dispozitave nga nenet 7, 8, 9 dhe 13 (paragrafi 3 dhe 4) - kompensimet dhe benefitet, të cilat ligji i ka caktuar të fillojnë të zbatohen nga 1 janari i vitit 2017.

Me këtë ligj rregullohet statusi dhe të drejtat e personave të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme apo personave të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme të cilët marrin kompensim mujor.

Përfitues të këtij ligji janë:

Paraplegjikët - personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme.

Tetraplegjikët ose (kuadriplegjikët) - personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme.

Ky ligj përfshinë të gjithë personat paraplegjik dhe tetraplegjik, pa dallim moshe, etnie, gjinie, të cilët vlerësohen nga Komisioni Vlerësues.

Të drejtat kryesore të parapara me këtë ligj janë:

Kompensimi: pagesë mujore në një shkallë të caktuar të pagës minimale në Kosovë (130-170 Euro). Qeveria e Republikës së Kosovës e ka caktuar shumën prej 150 Euro për këtë kompensim.

Pagesë shtesë: Për personat të cilët kanë pasoja të përhershme dhe të plota në inkontinencë, përdorin medikamente në baza ditore, kanë humbje të ndjeshmërisë së plotë të ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të plagëve dekubitare, marrin një shumë shtesë prej pesëdhjetë përqind (50%) të kompensimit.

Kujdestari Personal: Sipas vlerësimit të Komisionit Vlerësues, njihet edhe e drejta për një kujdestar personal, me qëllim të ofrimit të kujdesit dhe shërbimeve të domosdoshme ditore, i cili kompensohet (paguhet) në shumën e njëjtë sikurse personi paraplegjik apo tetraplegjik. Qeveria e Republikës së Kosovës e ka caktuar shumën prej 150 Euro për këtë kompensim. Pagesa për kujdestar bëhet në llogarinë bankare të personit që do ti njihet e drejta nga ky ligj, pra vet personit paraplegjik ose tetraplegjik. Nëse personi paraplegjik ose tetraplegjik dëshiron që pagesa e kujdestarit personal të bëhet e ndarë, atëherë duhet të bëhet një kontratë të Noteri, në këtë rast pagesa i bëhet kujdestarit personal.

Lirime nga taksat: për doganimin e automjetit, për regjistrimin e automjetit (edhe nëse automjeti është në emër të kujdestarit personal), për nxjerrje të certifikatave të gjendjes civile dhe për dokumentet personale (letërnjoftim, patentë shofer dhe pasaportë).

Lirim nga pagesat: për shkollim në të gjitha nivelet e shkollimit në institucionet publike dhe strehim në konviktet publike, për shërbimet shëndetësore në institucionet shëndetësore publike, lirim nga pagesa e premiumit për sigurimin shëndetësor, pajisje ndihmëse falas (p.sh: karroca), rehabilitim shëndetësor, fizik dhe social.

Po ashtu, tarifa të reduktuara të konsumit të energjisë elektrike, sipas kushteve të përcaktuara nga organet kompetente, transport publik urban falas, ndër-urban me zbritje 50% dhe përparësi në strehim në banesat sociale.

Kriteret për njohjen e statusit dhe të drejtave nga ligji

Të jetë qytetar i Republikës së Kosovës, të paraqesë kërkesë (Formularin) i cili merret dhe pas të plotësohet duhet të dorëzohet në Zyrën e Pensioneve.

Kërkesës (Formularit) duhet t'i bashkangjitur ose shtohen këto dokumente: Kopja e letërnjoftimit, ekstrakti i lindjes, raporte të vjetra mjekësore, mendimi (raporti) Konziliar i marrë në Klinikën e Neurologjisë në QKUK në Prishtinë, fatura e tatimit në pronë ose fatura e ujit, rrymës apo mbeturinave (si dëshmi për adresën dhe banimin në Kosovë), ndërsa nëse personi është i liruar nga këto pagesa duhet të prezantojë dëshmi për lirim, si dhe aktvendimin për kujdestari (për personat që kanë të caktuar kujdestari me ndonjë vendim të gjykatës).

Pas dorëzimit të Kërkesës (Formularit) të plotësuar së bashku me dokumentacionin e kërkuar, personat paraplegjik dhe tetraplegjik do të ftohen për vlerësim nga Komisioni Vlerësues, i cili mblidhet nëpër Zyrat Regjionale të Pensioneve.

Departamenti i Pensioneve është i obliguar të nxjerrë Vendim në afat prej 30 ditëve prej paraqitjes së kërkesës. Ndërsa personat e pakënaqur me Vendimin për njohjen e statusit, të drejtave dhe përfitimeve, kanë të drejtë ankese në afat prej 30 ditëve prej ditës së dorëzimit të vendimit. Ankesat i shqyrton Komisioni i Ankesave në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Nëse personi nuk është i kënaqur me vendimin e Komisionit të Ankesave, ka të drejtë të paraqesë padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje administrative.

Personave që iu njihet statusi dhe të drejtat nga ligji, NUK do t'i ndalen pagesat e kompensimeve edhe nëse janë të punësuar, vetëpunësuar apo ndonjë formë tjetër e punësimit.

LIGJI PËR PERSONAT E VERBËR

Ligji për Personat e Verbër është miratuar më 14 qershor 2012, ndërsa ka filluar të zbatohet nga 1 janari i vitit 2013.

Ky ligj ka për qëllim të rregullojë statusin ligjor të personave të verbër në Republikën e Kosovës, ndërsa fushëveprimi i tij është rregullimi i të drejtave dhe përfitimeve si dhe përcaktimi i kriterëve për kategorizimin e personave të verbër.

Përfitues të këtij ligji janë personat e verbër, e që sipas ligjit, person i verbër konsiderohet personi me humbje të plotë të pamurit të lindur ose të fituar të përcaktuar sipas kriterëve mjekësore të vlerësuara nga Komisioni Mediko-social. Ligji personat e verbër i ka kategorizuar në dy grupe, në grupin e parë janë personat që nuk e dallojnë dritën nga errësira, deri në qartësinë e të parit 0.02, ndërsa në grupin e dytë janë personat që kanë humbje pjesërisht të shikimit, mbi 0.02 deri 0.05.

Të drejtat kryesore të parapara me këtë ligj janë:

Kompensimi: pagesë mujore në një shkallë të caktuar bazuar në pagën minimale në Kosovë, por jo më pak se njëqind (100) Euro në muaj. Me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, aktualisht kjo shumë është 125 Euro për këtë kompensim.

Shoqëruesi: personave të verbër të grupit të parë i njihet edhe e drejta për një shoqërues. Qeveria e Republikës së Kosovës e ka caktuar shumën prej 125 Euro për shoqëruesin. Pagesa për shoqëruesin është duke u bërë në llogarinë bankare të personit të verbër.

Kriteret për njohjen e statusit të personit të verbër

Të jetë qytetar i Republikës së Kosovës (pa dallim moshe), të paraqesë kërkesë (Formularin) i cili merret dhe pasi të plotësohet duhet të dorëzohet në Zyrën e Pensioneve më të afërt në vendbanimin e personit të verbër.

Kërkesës (Formularit) duhet t'i bashkangjitur ose shtohen këto dokumente: Kopja e letërnjoftimit, certifikatën e lindjes, certifikatën e vendbanimit, raporte të vjetra mjekësore, mendimi (raporti) Konziliar i marrë në Klinikën e Syve në QKUK në Prishtinë dhe aktvendimin për kujdestari për fëmijët aplikues pa përfaqësues ligjor, si dhe dokumente tjera shtesë të cilat mund të përdoren si argumente.

Pas dorëzimit të Kërkesës (Formularit) të plotësuara së bashku me dokumentacionin e kërkuar, personat e verbër do të ftohen për vlerësim nga Komisioni Mediko-Social.

Departamenti i Pensioneve është i obliguar të nxjerrë Vendim për njohjen apo jo të statusit të personit të verbër. Ndërsa personat e pakënaqur me Vendimin për njohjen e statusit, të drejtave dhe përfitimeve, kanë të drejtë ankese në afat prej 30 ditëve prej ditës së dorëzimit të vendimit. Ankesat i shqyrton Komisioni i Ankesave në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies

Sociale. Nëse personi nuk është i kënaqur me vendimin e Komisionit të Ankesave, ka të drejtë të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë– Departamenti për çështje administrative.

Personave që iu njihet statusi dhe të drejtat nga ligji, NUK do t'i ndalen pagesat e kompensimeve edhe nëse janë të punësuar, vetëpunësuar apo ndonjë formë tjetër e punësimit.

LIGJI PËR SHËNDETIN MENDOR

Ligji është miratuar me 24.10.2015 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës , dhe ka hy ne fuqi me 13.11.2015

Ligji për shëndetin mendor ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve që lidhen më të, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime mendore.

Ligji përcakton procedurat dhe kushtet për mbrojtjen e shëndetit mendor nëpërmjet sigurimit të kujdesit shëndetësor, mjedisit social të përshtatshëm për personat me çrregullime mendore dhe politikave parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendore.

Të drejtat e personave me çrregullime mendore

1. Personat me çrregullime mendore gëzojnë:
2. Të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.
3. Të drejtën të marrin shërbim shëndetësor të arritshëm dhe efikas në kushte të barabarta si të gjithë pacientët e tjerë.
4. Të drejtën për trajtim dhe mbrojtje, bazuar në respekt të individualitetit dhe dinjitetit të tyre.
5. Të drejtën për të pranuar ose jo ndërhyrjen e propozuar diagnostike e terapeutike, përveç rasteve të tjera të parashikuara në këtë ligj.
6. Të drejtën për t'u informuar për të drejtat e tyre, si dhe për të qenë pjesë e hartimit të planit individual të trajtimit.
7. Të drejtën për të kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga gabimi në trajtim ose keqtrajtimet e mundshme.
8. Të drejtën për të kërkuar rishqyrtimin e shtrimit apo mjekimit të detyruar.
9. Të drejtën për konfidencialitet mbi të dhënat për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore.

10. Të drejtën për të mos u detyruar forcërisht të ekzaminohen nga pikëpamja mjekësore me qëllim përcaktimin e një çrregullimi mendor të mundshëm, me përjashtim të rasteve sipas procedurave të parapara në këtë ligj.

11. Të drejtën për t'u siguruar kushtet e përshtatshme jetësore, higjienike, të ushqyerjes dhe sigurisë.

12. Të drejtën për t'u ankuar për ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor.

Kategoritë e shërbimeve

1. Shërbimet shëndetësore, përmes të cilave ofrohet kujdesi për shëndetin mendor janë:

2. Kujdesi shëndetësor parësor.

3. Kujdesi shëndetësor dytësor.

4. Kujdesi shëndetësor tretësor.

LIGJI PËR SKEMAT PENSIONALE TË FINANCUARA NGA SHTETI

Që nga muaji qershor i vitit 2014, është në fuqi Ligji Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga shteti, i cili ligj e ka shfuqizuar Ligjin Nr.2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara. Ligji për skemat pensionale të financuar nga shteti i përfshinë të gjitha pensionet që financohen nga shteti, siç janë: pensionet bazike të moshës, pensionet kontribut paguese të moshës, pensionet e aftësisë së kufizuar (për moshat nga 18 – 65 vjeç), pensionet e parakohshme, pensionet familjare dhe pensionet invalidore të punës, si pensione të Shtyllës së I-rë të financuara nga shteti.

Pra nga muaji qershor i vitit 2014, pensionet e personave me aftësi të kufizuara (për moshat nga 18 – 65 vjeç) rregullohen me ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti, i cili në nenin 9 përcakton kriteret dhe procedurat e njohjes së pensionit.

Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension të paaftësisë të përhershme:

1. Pensioni i paaftësisë të përhershme do t'iu ofrojë mbështetje financiare personave të përzgjedhur në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë ligj, sipas mjeteve të ndara për këtë qëllim nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

2. Pensioni i paaftësisë së përhershme do t'iu paguhet të gjithë atyre personave që janë shtetas të Republikës së Kosovës, që posedojnë dokumentet e identifikimit dhe të cilët i kanë tetëmbëdhjetë (18) deri gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç.

3. Kërkesa për pension të paaftësisë së përhershme, duhet të parashtrohet në organet përkatëse të Ministrisë, të cilat janë të instaluar në Komunitatet e Kosovës (Zyrat e pensioneve).

4. Kërkesat për pension të paaftësisë së përhershme shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisionet Mjekësore, në Qendrat Rajonale të Administratës Pensionale.

5. Një person do të konsiderohet me paaftësi të përhershme, nëse ofron dëshmi se është me aftësi të përhershme para se të aplikojë për pension, duke siguruar të gjitha dëshmitë mjekësore, ndërsa Komisioni Mjekësor vlerëson se ekziston paaftësia e përhershme e punës të parashtruesi i kërkesës.

Komisioni Mjekësor vlerëson paaftësinë në kohëzgjatje për periudhën prej një (1), tre (3) apo pesë (5) vitesh, e cila nënkupton se vendimi për këtë pension lëshohet me afat një, tre ose pesë vjeçar. Pas skadimit të afateve të përcaktuara, personi i nënshtrohet procedurës së rivlerësimit mjekësor.

Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale apo Zyra e Pensioneve mund të bëjnë inspektime (kontrolle) të rastësishme apo sistematike të personave, të cilat marrin pensionin e paaftësisë së përhershme, me qëllim të verifikimit të fakteve të dhëna në kërkesë dhe vazhdimësisë së përzgjedhjes për shfrytëzimin e pensionit të aftësisë së kufizuar.

Procedurat për njohjen e të drejtës në këtë pension i zhvillon Administrata e Pensionale përmes Zyrave nëpër të gjitha Komunitatet/Qytetet e Kosovës. Procedurat aktuale janë: Kërkesa për pension i dërgohet Administratës Pensionale selia e së cilës është në vendbanimin e përhershëm të aplikuesit (në të gjitha qytetet/komunitatet e Kosovës). Formulari i kërkesës merret në Zyrat e Administratës Pensionale, parashtruesi i kërkesës duhet ta plotësojë kërkesën dhe ta nënshkruaj atë.

Kërkesës për realizimin e pensionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:

- a) fotokopjen e letërnjoftimit të parashtruesit të kërkesës;
- b) dokumentacioni mjekësor me epikriz-certifikatën mjekësore zyrtare mbi gjendjen shëndetësore të personit me aftësi të kufizuar (Raportet mjekësore që e dëshmojnë aftësinë e kufizuar).

Zyrtari i Administratës Pensionale ka për detyrë që të kontrollojë dokumentet e paraqitura dhe të kërkojë çdo dokument relevant dhe të tregojë se cilat dokumente duhet bashkëngjitur kërkesës.

Të drejtat nga ky ligj: vetëm pensioni mujor i cili aktualisht 75 euro në muaj. Rritjen e kësaj shume mujore mund ta bëjë qeveria.

Me rastin e punësimit apo vetë-punësimit, pensioni ndalet.

Ky pensioni jepet vetëm për personat me aftësi të kufizuara të cilët kanë pa aftësi të përhershme për punë, të cilët nuk i plotësojnë kriteret nga ndonjë ligj tjetër i aftësisë së kufizuar (psh: ligji për personat e verbër dhe ligji për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjik dhe tetraolegjik).

Pas dorëzimit të kërkesës për këtë pension, apo pas ri-vlerësimit, administrata pensionale nxjerr vendim për njohjen apo jo të pensionit. Ndërsa personat e pakënaqur me Vendimin për njohjen e pensionit, kanë të drejtë ankese në afat prej 30 ditëve prej ditës së dorëzimit të vendimit. Ankesat i shqyrton Komisioni i Ankesave në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Nëse personi nuk është i kënaqur me vendimin e Komisionit të Ankesave, ka të drejtë të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje administrative.

LIGJI PËR PËRKRAHJE MATERIALE FAMILJEVE TË FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR TË PËRHERSHME

Ky ligj është miratuar më 16 maj 2008, ndërsa është shpallur nga UNMIK-u më 14 qershor 2008, pra ligji më i vjetër në fuqi për personat me aftësi të kufizuara.

Me këtë ligj rregullohet e drejta për përkrahje materiale familjeve të cilët ruajnë dhe përkujdesen për fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme dhe mënyra e realizimit të kësaj përkrahje materiale. Ky ligj njihet të drejtën për një mbështetje financiare për çdo fëmijë me aftësi të kufizuara nga mosha 1 – 18 vjeçare, aktualisht shuma është 100 euro për muaj.

Kjo mbështetje jepet vetëm për fëmijët të cilët janë plotësisht të paaftë të kryejnë aktivitetet e përditshme jetësore pa kujdesin e personit tjetër.

Procedurat për njohjen e kësaj të drejte kryhet nga Qendrat për Punë Sociale, e cila i kryen procedurat e vlerësimit dhe vendosjes për kërkesat e paraqitura për këtë mbështetje.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

Krahas aplikacionit për realizimin e të drejtës për përkrahje financiare, aplikuesi duhet të bashkëngjisë edhe këto dokumente:

1. fotokopjen e letërnjoftimit të parashtruesit të kërkesës (prindi apo kujdestari);
2. informatën-vërtetimin nga Bashkësia Lokale për vendbanimin e fëmijës dhe familjes e cila përkujdeset për të;
3. certifikatën e lindjes për fëmijën (origjinale) jo më e vjetër se gjashtë muaj;
4. aktvendimin e kujdestarisë / nëse kërkesën e parashtron kujdestari (origjinale);
5. dokumentacionin mjekësor me epikrizë /certifikatën mjekësore zyrtare/ mbi gjendjen shëndetësore të fëmijës (origjinale) jo më e vjetër se gjashtë muaj.

E drejta për paraqitjen e kërkesës së re (ri aplikim):

Aplikuesit të cilit i është refuzuar kërkesa për realizimin e të drejtës në përkrahje materiale për fëmijën me aftësi të kufizuara të përhershme, ka të drejtë që të paraqesë kërkesë të re për realizimin e kësaj të drejte, nëse ndërkohë gjendja shëndetësore e fëmijës ka ndryshuar dhe është përkeqësuar.

Aplikuesi e fiton të drejtën në ri aplikim pas periudhës dy (2) vjeçare, prej kohës kur është vlerësuar dhe refuzuar nga ana e Komisionit Mjekësor të shkallës së parë, gjegjësisht nga vendimi përfundimtar i shkallës ankuese.

Në rastet kur Qendra për Punë Sociale nxjerr vendim refuzues, familja ka të drejtë ankese, nëse edhe pas ankesës refuzohet kjo mbështetje financiare, familja ka të drejtë për të bërë padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje administrative.

SUBVENCIONET E KOMUNAVE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR TË PËRHERSHME

Çdo person me aftësi të kufizuara, pavarësisht a është shfrytëzues i pensionit, mbështetjes materiale për familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara apo ndihmës sociale për familje, sa herë që gjendet në vështirësi financiare momentale për nevoja jetësore, gjendet në nevojë për ilaçe/medikamente, për ndonjë nevojë shëndetësore etj., mund të paraqesë në Komunë kërkesë për subvencion/ndihmë.

Komunat e Republikës së Kosovës në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për shërbimet sociale dhe familjare dhe në bazë të Statuteve të tyre, kanë nxjerrë Rregullore për Subvencione. Këto Rregullore kanë përcaktuar kriteret dhe proceduat për ndarje të subvencioneve për OJQ, për qytetarët në nevojë, përfshirë e personat me aftësi të kufizuara.

Për secilin rast që kërkoni subvencion, në kërkesë shkruhen të dhënat e personit, tregohet që jeni person me aftësi të kufizuara, merrni apo nuk merrni pension, apo skemat tjera shtetërore, jepen arsyet se përse tani keni nevojë për subvencion/ndihmë nga komuna, shumën financiare që ju duhet, pamundësinë që ju ta përballoni një shpenzim etj. Për ta bindur komunën që ju me të vërtet keni nevojë për subvencion/ndihmë, në varësi të nevojave kërkesës iu bashkëngjiten dokumente mjekësore, receta për medikamente, fatura të rrymës, certifikata të lindjes, certifikatën e bashkësisë familjare etj.

Shumica e komunave me rregulloret për subvencion kanë caktuar se kërkesa i dërgohet drejtorisë komunale e cila e mbulon atë fushë për të cilën ju keni nevojë, p.sh: për medikamente/ilaçe – drejtorisë së shëndetësisë; për shkollim – drejtorisë së arsimit, e kështu me radhë. Një pjesë tjetër e komunave kërkesat i pranon dhe duhet ti dërgohen Kryetarit të Komunës.

LIGJI PËR AFTËSIMIN, RIAFTESIMIN PROFESIONAL DHE PUNËSIMI I PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Kuvendi i Kosovës në vitin 2008 e ka miratuar Ligjin Nr.03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, i ndryshuar dhe plotësuar në vitin 2016.

Qëllimi i këtij ligji është përkrahja ligjore dhe institucionale për aftësim dhe përgatitje profesionale për punësim të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara duke u mbështetur në principet dhe tretmanin e mundësive të barabarta përfshirë edhe mundësitë gjinore.

Për të realizuar të drejtat nga ky ligji, personi i interesuar duhet të regjistrohet si punëkërkuar në Qendrat për Punësim. Për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, Qendrat për Aftësim Profesional angazhojnë komisionin profesional për caktim e aftësive për punë dhe njohjen e të drejtës në aftësim, riaftësim dhe punësim. Këto qendra ofrojnë aftësim dhe riaftësim profesional, sipas kërkesës së tregut të punës për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, bëjnë nxitjen e punësimit të përshtatshëm në përputhje me aftësitë e mbetura për punë, zhvillojnë programe, praktika dhe strategji për aftësim dhe nxitje për punësim, zhvillojnë programe edukative dhe ofrojnë trajnime apo kurse profesionale për profile adekuate për persona me aftësi të kufizuara.

Trajnimet, programet, punëtoritë për mësim të zanateve apo profesioneve të reja që këto qendra organizojnë për personat me aftësi të kufizuara kanë për qëllim që, personat të marrin profesione dhe të certifikohen me të cilat mund të gjejnë punë. Personat me aftësi të kufizuara duhet të vizitojnë ato qendra dhe të shprehin interesim për ti ndjekur programet aftësuese, që tani qendrat t'ju orientojnë për profilet adekuate për çdo person.

Në kushte të veçanta, personat me aftësi të kufizuara, mund të punësohen në Punëtoritë Mbrojtëse, Qendrat Punuese dhe në punë të tjera, në bazë të aftësive të punës dhe sipas kushteve të përgjithshme mund të punësohen në tregun e hapur të punës ose ta mbajnë punën e vet.

Në Kreun V të ligjit janë caktuar kushtet e punësimit, të cilat ligji i ka ndarë në kushte e përgjithshme dhe të veçanta. Sipas ligjit, personi me aftësi të kufizuara ka të drejtë në punësim, integrim në tregun e punës në kushtet përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara me këtë ligj. Në kushte të veçanta, personat me aftësi të kufizuara, mund të punësohen në Punëtoritë Mbrojtëse, Qendrat Punuese dhe në punë të tjera, në bazë të aftësive të punës.

Punësimi në kushte të veçanta konsiderohet edhe vetëpunësimi, si dhe punësimi në ekonominë familjare i personave me aftësi të kufizuara.

Me kushtet e përgjithshme të punësimit, nënkuptohet punësimi i personave me aftësi të kufizuara në tregun e hapur të punës.

Ndërsa, në tregun e hapur të punës obligimet që jepen për punëdhënësit për punësim të personave me aftësi të kufizuar, në nenin 12 të ligjit janë përcaktuar kështu: Neni 12 - Punësimi në tregun e hapur të punës, 1. Organet e administratës shtetërore, punëdhënësit e sektorit privat dhe publik si dhe organizatat joqeveritare obligohen që, me kushtet e përshtatshme të punës ti punësojnë personat me aftësi të kufizuara; 2. Çdo punëdhënës është i obliguar të punësoj një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor; 3. Punëdhënësi i cili nuk i përmbush detyrimet nga paragrafi 1 dhe 2 i nenit 12 të ligjit bazik, obligohet që për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara të paguajë në një xhirrollogari të veçantë në vijën buxhetore të Buxhetit të Kosovës, pagesat mujore në lartësi të shumës së pagës minimale të realizuar në Republikën e Kosovës, për çdo person me aftësi të kufizuar që duhet të kishte punësuar.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me akt të veçantë nënligjor, duhet të rregulloje dhe përcaktoje vendet e punës dhe punët e përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar.

Ligji parasheh disa lehtësira edhe për punëdhënësit që punësojnë persona me aftësi të kufizuar, e të cilat lehtësira janë për obligimet tatimore dhe pagesa të kontributeve pensionale për punëtor.

LIGJIT PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

TRANSPORTI SHKOLLOR PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Për fëmijët me vështirësi në mësim apo me aftësi të kufizuara, në bazë të Nenit 40 (paragrafi 4) të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, komunat kanë për obligim të sigurojnë ose ofruar transportin shkollor. Ky transport duhet të ofrohet pavarësisht largësisë së banimit të fëmijëve me shkollën, nëse fëmijët me aftësi të kufizuara për shkak të kufizimeve e kanë të vështirë shkuarjen dhe ardhjen në shkollë. Po ashtu ky ligj obligon edhe Ministrinë e Arsimit të siguroj transportin për fëmijët që vijnë në mësimet në Qendrat Burimore (ish-Shkollat Speciale).

Sipas nenit 40 të ligjit (Parimi i arsimit gjithëpërfshirës), sipas vlerësimeve individuale profesionale, komunat sigurojnë transport falas, të sigurt dhe të përshtatshëm për fëmijët me aftësi të kufizuara apo me vështirësi në mësim që ndjekin mësimet në shkollë komunale.

Nevoja për transport bëhet sipas vlerësimit profesional nga Ekipi apo Komision për Vlerësimin Profesional të fëmijëve me aftësi të kufizuara në kuadër të Drejtorive Komunale të Arsimit, me rastin e vlerësimit të përgjithshëm për fëmijët. Kur ky Ekip apo Komision e bënë vlerësimin, në vendim ceket edhe nevoja për transport shkollor, me ç' rast komuna ka obligim të ofroj apo siguroj këtë transport. Nevoja për transport mund të kërkohet çdo herë nga prindi, duke i parashtruar kërkesë Drejtorisë Komunale të Arsimit.

Kërkesës duhet bashkëngjitur dokumentacioni i nevojshëm siç janë: Ekstrakti i lindjes i fëmijës, vërtetim nga shkolla ku është i regjistruar fëmija, vërtetim nga Bashkësia Lokale për vendbanimin apo adresën e banimit të fëmijës, raport mjekësor për fëmijën si dëshmi për aftësinë e kufizuar, vërtetim për fëmijën nga shoqata si dëshmi për aftësinë e kufizuar, ndonjë dokument tjetër që mund ta kërkojë Drejtoria Komunale e Arsimit.

Pasi Drejtoria Komuna e Arsimit e pranon të drejtën për transport shkollor, ajo këtë transport mund ta ofroj në mënyra të ndryshme, siç janë: duke kontraktuar ndonjë kompani transportuese, duke kontraktuar ndonjë taksist (TAXI), duke i dhënë para prindërit që prindi me automjetin e vet të dërgojë fëmijën në shkollë etj. Këto mënyra të ofrimit të transportit nuk janë të përcaktuara në ligj, por disa komunave i praktikojnë këto forma apo mënyra të ofrimit të transportit.

Në rastet kur Drejtoritë Komunale të Arsimit refuzojnë të ofrojnë apo sigurojnë transportin shkollor për fëmijët me vështirësi në mësim apo me aftësi të kufizuara, prindërit duhet të paraqesin rastin tek Inspektorati i Arsimit (në Komunën përkatëse dhe Ministri të Arsimit, si dhe për këtë rast dhe raste tjera në lidhje me edukimin fillor kontaktoni edhe Edukatorët e HANDIKOS-it në Qendrat e HANDIKOS-it.

Raportimet tek Avokati i Popullit ose në media mund të ndikojnë pozitivisht në realizimin e të drejtës për regjistrim të fëmijëve si dhe në sensibilizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në shkollim. Si dhe në rastet kur Drejtoritë Komunale të Arsimit nxjerrin vendim për refuzim, duhet bërë ankesë sipas udhëzimit që jepet në vendim.

LEHTËSIRAT DOGANORE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Për personat me aftësi të kufizuar, për lehtësimin e lëvizjes dhe kryerjen e aktiviteteve ditore, janë të lejuara disa lehtësira doganore me qëllim të importimit pa paguar taksa doganore dhe të akcizës. Dispozitat ligjore për lirim nga pagesa e detyrimeve importuese për mjete ndihmese dhe automjete për personat me aftësi të kufizuar që kanë të drejtë lirimi është e paraparë me dispozitat e nenit 68-78 të aneksit “A” të Kodit Doganor dhe Akcizave 03/L-109.

Sipas këtij kodi, të drejtë lirimi nga pagesa e detyrimeve të importit kanë personat me aftësi të kufizuar për automjetet posaçërisht të dizajnuara apo përshtatur për personat me të meta fizike (që nënkupton se automjeti duhet ti ketë kryer adaptimet e komandave për drejtimin e automjetit duke ia përshtatur llojit të dëmtimit të ekstremiteteve). Pra, kjo është e drejtë personale, sepse automjetin e importuar mund ta zhdoganoj vetëm personi me aftësi të kufizuar për nevojat e veta (që nënkupton se duhet të posedojë patentë shofer dhe të vozis

vet). Pastaj, kusht është që personi duhet ta ketë të vërtetuar statusin si person me aftësi të kufizuar, i cili ka të drejtë në lirim (çka nënkupton se duhet të posedojë dëshminë përkatëse nga Institucioni i autorizuar mbi njohjen e aftësisë së kufizuar (Vendimi i pensionit dhe Vërtetimi i HANDIKOS-it), sepse këtë të drejtë nuk mund ta gëzojnë të gjithë personat me aftësi të kufizuar, por vetëm ata që i kanë të dëmtuara ekstremitetet në atë shkallë që nuk pengon drejtimin e automjetit). Me nenin 78 1(b) të aneksit të Kodit është përcaktuar ndalesa e huazimit, dhënies në shfrytëzim apo tjetërsimit të automjetit të liruar nga detyrimet importuese, përkatësisht në vështrim të nenit 80 detyrimi i pagesës së këtyre detyrimeve nëse automjeti huazohet, jepet në shfrytëzim apo tjetërsohet nga titullari i privilegjit doganor.

Në bazë të asaj që u cek më lartë, nevojiten këto dokumente për të gëzuar të drejtën e liritimit nga pagesa e taksës doganore për importim të veturave nga personat me aftësi të kufizuara:

1. Dëshminë nga Institucioni i autorizuar mbi pranimin e statusit të personit me aftësi të kufizuar (Vendimi i pensionit, Raport konzilar prej 3 mjekëve specialist në QKU, si dokument plotësues kërkohet edhe Vërtetimi dhe Libreza e HANDIKOS-it);
2. Patentë shoferin personal;
3. Dokumentet e automjetit me faturën apo kontratën e shitblerjes së automjetit të importuar;
4. Dëshmitë se në atë automjet janë bërë adaptime për përshtatjen e komandave të drejtimit nevojave të personit me aftësi të kufizuar (duhet ti bëhet përshtatje automjetit, duke i vendosur pajisje të cilat e lehtësojnë drejtimin e automjetit nga personi me aftësi të kufizuara);
5. A-testi i automjetit;
6. Homologimi;
7. Deklaratë me shkrim se në afatin brenda 5 vitesh nuk ka shfrytëzuar këtë të drejtë;
8. Në raste kur Dogana e konsideron të domosdoshëm çfarë do dokumenti tjetër.

Në fillim të procedurës për importim të automjetit duhet ta angazhoni një shpeditier doganor, i cili do t'ju lehtësoj përgatitjen e dokumenteve dhe realizimin e importimit.

Me qëllim të interpretimit adekuat të dispozitës 78 (2) ku thuhet se “automjetet apo mjetet tjera të transportit posaçërisht të dizajnuara apo përshtatura për personat me aftësi të

kufizuara”. Ky formulim nënkupton se automjeti i dedikuar për nevojat e personit të me aftësi të kufizuara duhet të jetë i adaptuar (përshtatur) për përdorim personal nga personi, ndërsa adaptimi nënkupton përshtatjen mekanike të komandave të drejtimit të automjetit në bazë nevojave konkrete të personit të personit me aftësi të kufizuar. Kjo e drejtë mund të realizohet çdo 5 vite. Ndërsa automjetin që një herë e keni importuar pa paguar doganë, mund ta shitni, por blerësi nëse nuk është person me aftësi të kufizuara obligohet ta paguaj doganimin, kurse blerësi nëse është person me aftësi të kufizuara dhe i plotëson kriteret për lirim, automjeti mund të përkthehet pa paguar doganim.

Sqarim: Personat me aftësi të kufizuara mund të liroheni nga pagesa e detyrimeve importuese për automjetet e importuar të udhëtarëve në cilësinë e personit me aftësi të kufizuara nëse të njëjtit posedojnë dëshmi nga institucioni i autorizuar mbi pranimin e statusit të personit të me aftësi të kufizuara, të posedojnë patentë shofer dhe nëse në automjetin e importuar paraprakisht janë bërë përshtatja e komandave të drejtimit nevojave sipas llojit të aftësisë së kufizuar të personit, mund të përfitojnë lirim nga detyrimet importuese.

LIGJI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Ligji për mbrojtjen nga Diskriminimi që ka hyrë në fuqi në vitin 2015, garanton të drejtat për qytetaret, në trajtim të barabartë duke siguruar mbrojtje nga çdo formë e diskriminimit

Çka është diskriminimi ?

Diskriminimi është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuar me Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi, që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësoj ose cenoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin në mënyrë të barabartë me të tjerët, të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës

Qëllimi i Ligjit për mbrojtjen nga Diskriminimi

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar, orientimit politik, moshës, gjendjes familjare, gjendjes shëndetësore, **aftësisë së kufizuar**, trashëgimisë gjenetike, ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të trajtimit të barabartë.

Diskriminimi në bazë të aftësisë së kufizuar

Ky diskriminim është atëherë kur një person me aftësi të kufizuara trajtohet me keq se një person pa aftësi të kufizuara në rrethana të njëjta ose të ngjashme.

Çka është aftësia e kufizuar ?

Aftësia e kufizuar është një dëmtim fizik, mental, intelektual ose ndijor. Pengesat e ndryshme mund të pengojnë personat me aftësi të kufizuara në pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në bazë të barabarta me të tjerët.

Diskriminimi i cili prek grupin e personave

Diskriminimi i cili prek grupin e personave (në këtë rast po iu referohem personave me aftësi të kufizuara), mund të iniciohet nëpërmjet një veprimi grupor të ndërmarr në emër të tyre nga një organizatë joqeveritare ose nga Avokati i Popullit, të raste e tilla, nuk kërkohet pëlqimi i anëtarëve të grupit.

Një person mund të përjetoj diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar

-Në situata kur ata përballen me pengesa në qasje në punësim, edukim, të mira dhe shërbime, si rezultat i mungesës së ashensorëve, pjerrinave dhe rampave, vend parkimeve të shënuara për persona me aftësi të kufizuara ose përkthimit në gjuhën e shenjave.

-Në kushtet kur personave me aftësi të kufizuara nuk iu ofrohet cilësia e njëjtë e kujdesit mjekësor sikurse personave pa aftësi të kufizuara, ose niveli i njëjtë i ndihmës sociale sikurse të tjerëve me dëmtime të ngjashme, pavarësisht nga shkaktari ose origjina e vetë dëmit

-Në vend të punës, kur personat me aftësi të kufizuara përjashtohen për shkak të perceptimeve dhe paragjytimeve se ata/ato nuk mund të jenë produktiv në punë sikurse të tjerët, dhe të aftë të kryejnë punë të caktuara.

-Mos akomodimi i përshtatshëm i vendit të punës komform nevojave të personave me aftësi të kufizuara. Kjo nënkupton se punëdhënësi duhet të ndërmerri masa përkatëse që t'i përshtat procedurat normale, proceset apo infrastrukturën, me qëllim që t'i mundësojë personit me aftësi të kufizuara që të ketë qasje në realizimin e të drejtës së punës.

Të drejtat e personave të diskriminuar në bazë të aftësisë së kufizuar

Personi i cili pohon se ka qenë i diskriminuar në bazë të aftësisë së kufizuar mund të ngre padi kundër diskriminimit para organeve administrative apo gjyqësore të cilat janë kompetente për sferën e caktuar, e që në këtë rast padia duhet bërë në Gjykatën Themelore ku ka ndodhur diskriminimi. Nëse mendoni se jeni viktimë e diskriminimit apo konsideroni se parimi i barazisë nuk është zbatuar ndaj jush, mbi bazat e përmendura në Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi ju duhet të paraqitni prova para organit administrativ apo gjykatës kompetente.

Kush mund të ndihmon ?

Avokati i Popullit është institucion i pavarur i shtetit, i cili trajton rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin të shkaktuar nga sektori publik ose privat. Avokati i Popullit pranon dhe heton parashtrirat e personave, ndërmjetëson, jep mendime dhe rekomandime për rastet konkrete të diskriminimit. Çdo person apo grup i personave mund t'i parashtrij ankesë Avokatit të Popullit lidhur me sjelljen diskriminuese mbi bazat e përmendura me neni 1 të këtij Ligji.

Gjobat në rast të diskriminimit

Nëse gjykata ose organi administrativ ka konstatuar diskriminimin, personi i cili ka kryer aktin diskriminues mund të paguan kompensim për dëmin material dhe moral. Kjo gjobë mund të jetë prej 400 euro (katërqind euro) deri në 1350 euro (njëmijë e treqind e pesëdhjetë)

Publikuar nga:
HANDIKOS
Veterrnik rr. Nekibe Kelmendi pn,
10000 Prishtinë, Republika e Kosoves

Web:www.handi-kos.org
E-mail:handikos@handi-kos.org
Facebook: HandiKOS

Mbështetur nga organizata Kynnys - Finlandë

Kynnys

Prishtinë, Dhjetor 2017